



Emri i Pritësit Client Name	29-11	2022	2 viti god year
Emri i Ndarjes Organi / Institucioni Org. Unit	No. Prot. Bil. Prot. Prot. No.	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMSHCK	7486/2022		1/3



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.Nr.961/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga Eshref Shabani-kryetar, Arben Mehmeti dhe Malsore Gashi Bajraktari-anëtarë, si dhe Çlirim Zeka, Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.961/2022 të datës 31.10.2022 të parashtruar nga ankuesi _____ me adresë _____ kundër organit të punësimit Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale, në çështjen juridike “Kontestim Konkursi”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 si dhe neni 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 i Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 29.11.2022, mori këtë:

V E N D I M

PËRFUNDON procedimi administrativ i filluar me ankesën me numër A.nr.961/2022 i datës 31.10.2022 e parashtruar nga ankuesi _____

A r s y e t i m

Ankuesi _____ përmes emailit ankesa.kpmschck@rks-gov.net, më datë 28.10.2022 ka parashtruar ankesë e cila në Këshill është regjistruar me numër protokollit 6583/2022 me datë 31.10.2022, kundër mos përfshirjes në listën e shkurtër për pozitën “Drejtor i Përgjithshëm” në Komisionin e Pavarur për Miniera dhe Minerale.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 11.11.2022 ankesën e ankuesit e ka dërguar tek Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale për përgjigje në ankesë. Ndërsa më datë 22.11.2022 përmes emailit Këshilli ka pranuar përgjigje në kërkesë nga Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me Nr.protokolli 6583/2022 të datës 31.10.2022 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; E-mail nga F.G. për ankesa.kpmshek@rks-gov.net i datës 28.10.2022; Vendim me numër Ref.003/0-1/KPMM i datës 20.10.2022; Ankesë e datës 24.10.2022; Certifikatë Shëndetësore për punësim e F.G. e datës 24.10.2022; Përgjigje në ankesë me numër Ref.003/0-1/KPMM i datës 27.10.2022; Vërtetim me numër protokolli 1161/264 i datës 25.10.2022; Formulari i Regjistrimit të ankesës i F.G.; Kërkesë për përgjigje në ankesë me numër protokolli 7044/2022 e datës 11.11.2022; Përgjigje në ankesë me numër protokolli 7319/2022 i datës 22.11.2022; Njoftim me numër protokolli 3980 i datës 16.11.2022; Njoftim me numër protokolli 3894 i datës 09.11.2022; E-mail nga F.M. për A.B. i datës 09.11.2022; E-mail nga S.P. për MINES IT i datës 09.11.2022;

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës, ka konstatuar së ekziston baza ligjore për përfundimin e procedimit administrativ të filluar me ankesën e ankuesi *sepse:*

Nga administrimi i provave materiale, Kolegji i Këshillit ka konstatuar se Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale, më datë 01.09.2022 ka shpallur konkursin me kodin e shpalljes RN00009875 për pozitën “Drejtor i Përgjithshëm 1” në KPMM. Në këtë konkurs ka aplikuar edhe ankuesi, mirëpo i njëjti nuk është përfshirë në listën e shkurtër.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, parashtron ankesë ndaj përgjigjes në ankesë me nr. Ref.003/0-1/KPMM të datës 27.10.2022.

Kryesuesja e Sektorit të Personelit të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale me datë 09.11.2022 përmes emailit ka njoftuar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës se kjo njësi ka nxjerr Njoftimin me numër protokolli 3894 të datës 09.11.2022 përmes të cilit janë shfuqizuar të gjitha vendimet për të gjithë kandidatët lidhur me vendimin paraprak për pozitën Drejtor i Përgjithshëm në Komisionin e Pavarur për Miniera dhe Minerale. Ndërsa Njësia e Burimeve Njerëzore e Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale më datë 16.11.2022 ka nxjerr Njoftimin me numër protokollit 3980 lidhur me vlerësimin e listës së ngushtë për pozitën e lartcekur ku përmes të cilit njoftim ankuesi është njoftuar për përfshirjen në listën e shkurtër dhe i njëjti do të vazhdoj procedurat e mëtutjeshme lidhur me këtë pozitë.

Kolegji i Këshillit, duke marr për bazë rrethanat e reja, konkretisht Njoftimin me numër protokollit 3980 të datës 16.11.2022 të Njesisë së Burimeve Njerëzore të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale përmes të cilit ankuesi është përfshirë në listën e shkurtër për pozitën Drejtor i Përgjithshëm–1 në Komisionin e Pavarur për Miniera dhe Minerale, atëherë edhe pretendimet e ankuesit për mos përfshirje në listën e shkurtër sipas vendimeve paraprake konkretisht objekti për të cilën ka filluar procedimi administrativ sipas ankesës se ankuesit është bërë i pamundur, sepse pretendimi i ankuesit që të hedhet poshtë refuzimi i aplikacionit për mos përfshirje në listën e shkurtër është shfuqizuar, rrjedhimisht në kuptim të dispozitave të nenit 104 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: *“Procedura administrative gjithashtu përfundon kur organi publik kompetent vlerëson se objekti për të cilin ishte nisur procedura ose qëllimi i saj është bërë i pamundur apo i kotë”*, Kolegji i Këshillit konstaton se janë plotësuar kushtet ligjore për përfundimin e procedurës administrative të filluar me ankesën me numër A.nr.961/2022 të datës 31.10.2022 të parashtruar nga ankuesi

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas analizimit dhe vlerësimit të gjitha shkresave të lëndës dhe provave të ofruara nga palët, duke u bazuar në kompetencën e Këshillit dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt, administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
LËNDA ME NUMËR A.NR.961/2022

Çlirim ZEKA

Çlirim ZeKa
Procesmbajtës

Eshref SHABANI

Eshref Shabani
Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Komisionin e Pavarur për Miniera dhe Minerale,
- Arkivit të KPMSHCK-së.

